

### Çfarë dokumentesh duhen paraqitur për të përfituar shumën e kompensimit?

Depozituesi duhet të paraqitet në sportelet e bankës agjente ose të bankës së vendosur në likuidim, në varësi të mënyrës së kryerjes së kompensimit, me dokumentet e identifikimit dhe kopje të dokumenteve të mëposhtëm:

- dokument i depozitës;
- dëshmi të trashëgimisë;
- çdo dokument tjetër që vërteton pretendimin mbi kompensimin e depozitës.

### Çfarë duhet bërë në rast se refuzohet pagesa ose ka pakënaqësi lidhur me shumën e kompensimit?

Çdo depozitues mund të paraqesë ankimin e tij në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me kompensimin e depozitave pranë Agjencisë. Ankimi mund të bëhet brenda 14 ditëve nga marrja e njoftimit për kompensim, të cilin depozituesi ankimon.

### MBANI MËND:

**TË DHËNAT MINIMALE QË ÇDO DEPOZITUES DUHET TË REGJISTROJË NË BANKË PËR TË MUNDËSUAR IDENTIFIKIMIN E SAKTË NË RAST KOMPENSIMI, JANË MINIMALISHT 7 (SHTATË):**

- emri;
- mbiemri;
- atësia;
- datëlindja;
- numri i dokumentit të identifikimit;
- adresa;
- numri i telefonit;

### KESHILLA PRAKTIKE:

- depozitoni një kopje të dokumentit të identifikimit në bankë;
- mbani me vete dhe identifikohuni në sportelin e bankës me të njëjtin dokument identifikimi;
- njoftoni menjëherë bankën për çdo ndryshim të të dhënave të mësipërme;
- depozitoni nënshkrimin apo firmën dhe nënshkruani/firmosni çdo dokument bankar që tregon apo autorizon lëvizjet nga llogaria depozitë e juaj;
- çdo neglizhencë lidhur me veprimet e mësipërme do të vështirësojë e vonojë procesin e identifikimit tuaj dhe të veprimeve tuaja bankare në rast nevojë;
- njoftoni Agjencinë për çdo parregullsi që vëreni në drejtim të mbajtjes së të dhënave të mësipërme dhe të procesit të identifikimit tuaj.

## KONTAKT


Për informacione apo pyetje të ndryshme ju mund të na kontaktoni në:  
Rruga e Elbasanit, Nr. 317  
Tiranë - Shqipëri

t: +355 42 362 989, 42 347 298

f: +355 42 362 984

e: [info@asd.gov.al](mailto:info@asd.gov.al)

[www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al)



**TË GJITHA BANKAT E NIVELIT TË DYTË QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË JANË ANËTARETË SKEMËS SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE.**



AGJENCIA  
E SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE

**DEPOZITAT**

**TUAJA JANË**

**TË MBROJTURA**



Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) siguron dhe kompenson depozitat tuaja deri në

**2.500.000 lekë**

[www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al)

## A sigurohen depozitat e individëve në banka?

Depozitat e individëve në banka sigurohen nga **Agjencia e Sigurimit të Depozitave**, e cila ushtron veprimtarinë bazuar në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave".

## Cilat banka sigurohen nga ASD?

Të gjitha bankat që ushtojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë dhe janë licencuar nga Banka e Shqipërisë.

## Kush përfiton nga sigurimi dhe kompensimi i depozitës?

Përfitues është **çdo individ** rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj, **i cili ka llogari depozite në një bankë** në lekë ose në monedhë të huaj.

## Kush përjashtohet nga sigurimi i depozitës?

Janë të përjashtuar nga sigurimi dhe nuk përfitojnë kompensimin e depozitave të tyre në bankë:

- Pjesa e depozitës në bankë ose në degën e bankës së huaj mbi 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë ose shuma e barasvlerëshme me të (kundërvleftën), në monedhë të huaj;
- Depozitat e bankës, degës së bankës, degës së huaj në emër dhe për llogari të vet;
- Depozitat e drejtorit, administratorit të bankës dhe të afërmeve të ngushtë të tyre sipas përcaktimit në ligjin për bankat;
- Depozitat e çdo personi që zotëron 5 (pesë) për qind ose më shumë në kapitalin e subjektin anëtar ose të aksioneve me të drejtë vote në këtë subjekt;
- Depozitat e prejardhura nga veprimtari të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë deklaruar të paligjshme me vendim gjykatë të formës së prerë;
- Depozitat e tregtarëve, vendas ose të huaj;
- Depozitat e personave juridikë, vendas ose të huaj;
- Depozitat e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, vendase ose të huaja;
- Depozitat e subjekteve të sipërmarrjes ose investimeve kolektive, vendase ose të huaja;
- Depozitat e fondeve të pensionit ose sigurimit pensional, vendase ose të huaja;
- Tituj të emtuara nga subjekte financiare dhe çdo lloj detyrimi tjetër që këto subjekte kanë bazuar mbi marrëveshjet e tyre të premtimit;
- Depozitat e njëjësive të pushtetit qendror ose vendor të Republikës së Shqipërisë ose të një vendi të huaj;
- Depozitat të paemëtuara dhe/ose titulli i të cilave nuk përcaktohet qartë;
- Depozitat e vendosura në subjektin anëtar të skemës së sigurimit të depozitave gjatë dhe pas ditës së ngjarjes së sigurimit në këtë subjekt.

## Sa është niveli maksimal i kompensimit?

Agjencia kompenzon **çdo depozitues** në masën 100 për qind dhe në çdo rast **jo më shumë se 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë** pavarësisht numrit të depozitave apo shumës së depozituar **në çdo bankë**. Sigurimi mbulon çdo individ në secilën bankë të sistemit bankar.

## A duhet të paguajë depozituesi për sigurimin e depozitës?

**Jo, depozituesi nuk paguan për të qenë i mbuluar me sigurim.** Është banka ajo që i paguan primin ASD-së.

## A është detyrim i bankave që të informojë individin mbi sigurimin e depozitave?

Po, banka është e detyruar t'ju informojë në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitës tuaj, skemën e sigurimit të depozitave, nivelin maksimal të kompensimit, institucionin që kryen pagesën e kompensimit dhe kush përjashtohet nga mbulimi.

## Si përlllogaritet shuma që përfiton çdo depozitues në kompensim?

Shuma në lek që përfiton çdo individ në rast kompensimi, llogaritet mbi shumën totale të depozitave të tij, të mbuluara nga sigurimi, në një bankë, përfshirë interesin e llogaritur deri në ditën e vënies së bankës në likuidim për secilën prej depozitave, duke zbritur shumën e detyrimeve të papaguara në kohë prej individit ndaj bankës:

$$\begin{matrix} \text{Totali i depozitave} \\ \text{të individit} \\ \text{në bankë} \end{matrix} + \begin{matrix} \text{Totali i interesave} \\ \text{të maturuar} \\ \text{për secilën depozitë} \end{matrix} - \begin{matrix} \text{Detyrimet e papaguara} \\ \text{në kohë të} \\ \text{individit ndaj bankës} \\ \text{\& kamatëvonesat /} \\ \text{penalitetet} \end{matrix} = \begin{matrix} \text{Vlera që përfiton} \\ \text{depozituesi} \\ \text{në kompensim deri në} \\ \text{2.500.000 lekë} \end{matrix}$$

### Shembull:

Mira ka dy depozita në bankë.

Mira	Balanca në lek
Depozita 1	2.200.000
Depozita 2	800.000
Interesi	5.000
Totali	3.005.000
Shuma maksimale e kompensimit	2.500.000
Detyrime të papaguara në kohë (kamatëvonesa/penalitetet)	100.000
Kompensohet	2.400.000

## Ç'ndodh me pjesën e depozitës mbi 2.500.000 lekë?

Pjesa e depozitës që tejkalon 2.500.000 lekë do të kompensohet nga likuidatori, sipas rradhës së kreditorëve dhe në varësi të të ardhurave që ai rimerr nga shitja e asetëve të bankës së falimentuar.

## Çfarë ndodh me depozitat e përbashkëta? Si do të bëhet kompensimi në këtë rast?

Pjesa përkatëse e secilit prej depozituesve merret parasysh në llogaritjen e shumës së përgjithshme të depozitave që ka depozituesi në bankën anëtare të skemës. Supozohet se çdo depozitues zotëron pjesë të barabarta në depozitën e përbashkët përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kontratën e vendosjes së depozitës.

### Shembull:

Depozitues	Depozita	Balanca në lek
Depozitues 1 + Depozitues 2	E përbashkët	6.000.000
Pjesa Depozitues 1		3.000.000
Kompensimi Depozitues 1		2.500.000
Pjesa Depozitues 2		3.000.000
Kompensimi Depozitues 2		2.500.000

Nëse keni një depozitë individuale dhe një depozitë të përbashkët, atëherë vlera që përfitohet në kompensim do të llogaritet përsëri deri në 2.500.000 lekë, mbi të dyja depozitat së bashku.

### Shembull:

Depozitues	Depozita	Balanca në lek
Depozitues 1	Individuale	1.000.000
Depozitues 1 + Depozitues 2	E përbashkët	4.000.000
Totali Depozitues 1		3.000.000
Kompensimi Depozitues 1		2.500.000
Totali Depozitues 2		2.000.000
Kompensimi Depozitues 2		2.000.000

## Po në rastin e depozitave në valutë?

Këto depozita do të kompensohen deri në limitin e përcaktuar nga ligji, duke u konvertuar në lek sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e vënies së bankës në likuidim.

## Sa kohë zgjat procesi i kompensimit?

Procesi i kompensimit nis në momentin kur ASD njoftohet nga Banka e Shqipërisë për ndërhyrje në bankën me probleme. Ky proces përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të tij.

## Cilat janë mënyrat e kompensimit?

Kompensimi kryhet përmes:

- pagesës së shumës në lek personit në ambientet e një banke anëtare të skemës (banka agjente);
- pagesës së shumës në lek personit në ambientet e subjektit të vendosur në likuidim në bashkëpunim me likuidatorin;
- transfertës së shumës që përfitohet nga depozituesi në një bankë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;